**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644 – 25 – 1748 – 1-3-6/C1033**
**14 Nr. 365/25**
**Dt. 16.05.2025**

# KONTRATË FURNIZIMI

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejmë **PORORSITËSI**) , dhe

2. **" Migros - 2 "sh.p.k.** me seli në **Vushtrri,** me **ARBK : 810017310,** të cilën e përfaqëson **z. Sami Plakolli,** në tekstin e mëtejmë: **FURNIZUESI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontrate publike për furnizime, si vijon: **Furnizimi me pajisje të T.I. dhe të komunikimit** , me numër prokurimi :

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i prokurimit** | **VU644** | **2** | **5** | **17** | **4** | **8** | **1** | **3** | **6** |
| **Nr. i brendshëm** | **644** | **2** | **5** | **0** | **0** | **8** | **1** | **3** | **6** |

**Neni 1 Lënda**
1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me pajisje të IT dhe të komunikimit (mjete konkretizimi për kabinetin e TIK) në pajtim me Aneksin 1 dhe Listës së përshkrimit të artikujve,** sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : 644-25-008-136

**Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: **15 ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës.**

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë : **shkollat sipas Regjistrit të Njësisë Kërkuese të A.K..** Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së mallit do të bëhet nga Menaxheri i Kontratës, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Menaxherit të Kontratës të A.K.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP[1] (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

2.4 Në rast se Furnizuesi dështon në përmbushjen me kohë të detyrimit si në paragrafin paraprak të këtij neni, Blerësi mbanë të drejtën që për secilën ditë në vonesë të Furnizuesit, të zbatoi penale me 0,25% të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës, në çdo ditë të vonesës.

[17] DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara --Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **8,790.00 €( tetmijshtatqindnëntëdhejet/00€ ).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do ti nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës, respektivisht pas pranimit të mallit nga ana e Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues.

**Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
(f) Plani për menaxhimin e kontratës;
(g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[2] në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues: Komuna Vushtrri** — **Për: " Migros -2 "sh.p.k. – Vushtrri**

| | | | |
|---|---|---|---|
| *Emri:* | **Ilmi Azemi** | *Emri:* | Sami Plakolli |
| *Pozita:* | Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik | *Pozita:* | Drejtor |
| *Nënshkrimi:* | [signature] | *Nënshkrimi:* | [signature] |
| *Data:* | 16.05.2025 | *Data:* | 16.05.2025 |
| *Vula:* | [stamp: REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E VUSHTRRISË – DREJTORIA PËR PROKURIM PUBLIK] | *Vula:* | [stamp: SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA – MIGROS-2 – VUSHTRRI – LIMITED LIABILITY COMPANY] |

2 Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **VU644-25-1748-1-3-6/C1033**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|---|---|
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Komerciale në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike. |
| Siguria e ekzekutimit | 8.1 | : 10 % ( dhjetë përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës.<br>Dokumenti - Polisa e sigurimit apo dokument banka të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 45 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës |
| Sigurimi | 9.1 | |
| Cilësia e furnizimeve | 16.2 | Pranimi paraprak është i nevojshëm dhe do të kryhet nga ana e Menaxherit të Kontratës. |
| Inspektimi dhe testimi | 17.2 | Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së mallit do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lënd e kësaj kontrate, nga Menaxheri i Kontratës , i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues.<br>Asnjë furnizim i mallit nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues. |
| Dorëzimi | 19.3 | Dorëzimi konsiderohet i përfunduar pas pranimit dhe konfirmimit të cilësisë, përshtatshmërisë dhe sasisë së mallit të pranuar nga Menaxheri i Kontratës i A.K. |
| Obligimet e garancionit | 22.1 | Kontraktues është përgjegjës për cilësinë dhe sasinë e mallit të dorëzuar në momentin e kontrollit të cilsisë dhe sasisë së mallit që është object i kontrollit nga ana e Menaxherit të Kontratës të A.K. |
| | 22.5 | Në rast të vlerësimit negative të cilësisë apo sasisë së mallit nga ana e Menaxherit të Kontratës të A.K., Kontraktuesi është i obliguar të verpoj sipas Rekomandimit të Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes | 29.2 | Konform nenit 29 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 30.1 | Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike. |

## Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

| *Nr.* | *Përshkrimi i shërbimeve* | *Njësia Matëse* | *Sasia* |
|---|---|---|---|
| 1 | **IBRAND NAME TABLET,**<br>**Display: 8.7" TFT LCD, 1340 x 800 pixels,**<br>**RAM: 8GB , Storage: 128GB,**<br>**Operating System: Android 13 ,**<br>**Battery: 5100 mAh ,**<br>**Port: USB Type-C ,**<br>**Rear Camera: 8 MP ,**<br>**Front Camera: 2 MP ,**<br>**Speakers: Stereo with Dolby,**<br>**Connectivity: Wi-Fi 802.11 a/b/g/n/ac,**<br>**Bluetooth 5.0, LTE (optional)** | copë | 12.00 |
| 2 | **Specifikacioni për TV**<br>**LED TV 65" Brand Name**<br>**Smart TV,**<br>**Procesori: Quad Core**<br>**Përmasat: 65" (165 cm)**<br>**Rezolucioni: 4K Ultra HD (3840 x 2160)**<br>**Sistemi operativ: Android**<br>**2 x HDMI, 2 x USB**<br>**Wi-Fi i integruar** | copë | 15.00 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **Zëri: 20 W**<br><br>**Kabllo HDMI gjatësi 10 metra**<br><br>**Kanale plastike të murit për vendosjen e kabllos HDMI dhe kabllos elektrike deri në prizë**<br><br>**Mbajtëse muri, montimi është i përfshirë në çmim**<br><br>**Garancioni: 2 vite** | | |

3hënim: Te përshkrimi I çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
ië kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8 apo 18, e jo në formatin ~~0%, 8% apo 18%,~~
idërsa në kolonën G, duhet te plotësoni me çmimin për njësi me TVSH.
Çmimi duhet të shkruhet me dy decimale pas presjesë dhjetore, në të kundërten nuk do te merret per bazë numri i tret pasë presjes

| Nr. | Përshkrimi i shërbimeve | Njësia Matëse | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSH | Norma e TVSH-së në % | Çmimi për njësi (me TVSh)-€ | Totali (Pa TVSH) | TVSH | Totali (me TVSH)-€ |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | IBRAND NAME TABLET,<br>Display: 8.7" TFT LCD, 1340 x 800 pixels,<br>RAM: 8GB , Storage: 128GB,<br>Operating System: Android 13 ,<br>Battery: 5100 mAh ,<br>Port: USB Type-C ,<br>Rear Camera: 8 MP ,<br>Front Camera: 2 MP ,<br>Speakers: Stereo with Dolby,<br>Connectivity: Wi-Fi 802.11 a/b/g/n/ac,<br>Bluetooth 5.0, LTE (optional) | copë | 12.00 | 440.68 | 18.00 | 520.00 | 5,288.14 | 951.86 | 6,240.00 |
| 2 | LED TV 65" Brand Name<br>Smart TV,<br>Procesori: Quad Core<br>Përmasat: 65" (165 cm)<br>Rezolucioni: 4K Ultra HD (3840 x 2160)<br>Sistemi operativ: Android<br>2 x HDMI, 2 x USB<br>Wi-Fi i integruar<br>Zëri: 20 W<br>Kabllo HDMI gjatësi 10 metra<br>Kanale plastike të murit për vendosjen e kabllos HDMI dhe kabllos elektrike deri në prizë<br>Mbajtëse muri, montimi është i përfshirë në çmim | copë | 15.00 | 144.07 | 18.00 | 170.00 | 2,161.02 | 388.98 | 2,550.00 |
| | **TOTALI I PËRGJITHSHËM:** | | | | | | **7,449.15** | **1,340.85** | **8,790.00** |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|---|
| EMRI I OE: | Migros-2 SH.P.K. |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | Sami Plakolli |
| NËNSHKRIMI: | SPlakolli |
| DATA: | 25.03.2025 |
| VULA: | SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA MIGROS-2 VUSHTRRI LIMITED LIABILITY COMPANY |